



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E INTEGRIMIT EUROPIAN

**RAPORT Nr. 1/2017
PËR ECURINË E PROCESIT TË INTEGRIMIT**

drejtuar

**KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN, KUVENDI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

për periudhën

JANAR–MARS 2017

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
ECURIA E ZBATIMIT TË MSA-SË.....	3
VEPRIMTARIA E ORGANEVE MONITORUESE TË PROCESIT TË INTEGRIMIT.....	3
TAKIMET PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË MSA.....	4
ZBATIMI I NENIT 70 TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIMIT: PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME ACQUIS E BASHKIMIT EVROPIAN	4
PARAPËRGATITJE PËR PROCESIN E NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN	6
MONITORIMI I PROGRESIT TË ARRITUR NË PESË PRIORITETET KYÇE GJATË PERIUDHËS JANAR-MARS 2017....	6
PËRAFRIMI DHE PËRKTHIMI I LEGJISLACIONIT	7
PLANI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EVROPIAN.....	9
FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE	11
AKTIVITETE TË TJERA	12
BASHKËPUNIMI TERRITORIAL	12
IPA KOMBËTARE	14

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
DBE	Delegacioni i Bashkimit Evropian
GMIP	Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave
GNPIE	Grupet Ndërinstitucionale të Punës të Integrimit Evropian
MED	Programi Transnacional Mesdheu
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integrimit Evropian
MSHCV	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para- anëtarësimit
KE	Komisioni Evropian
KKIPA	Koordinatori Kombëtar i IPA-s
KKNIE	Komiteti i Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian
KPM	Komiteti i Përbashkët i Monitorimit
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
SPD	Dokumentit të Planifikimit Sektorial
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WBIF	Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor

Hyrje

Bazuar në Ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, neni 19, pika 1, Ministria e Integritimit Evropian (MIE) paraqet çdo 3 muaj, pranë Komisionit Parlamentar të Integritimit, një raport të hollësishëm mbi listën e përditësuar të projektligjeve të lidhura me çështjet e integritimit evropian, të cilat do t'i kalojnë për shqyrtim Kuvendit për periudhën vijuese; ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim; raportimet e paraqitura pranë strukturave të Komisionit Evropian apo strukturave të përbashkëta, qëndrimet mbi çështjet e diskutuara, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga këto takime, zhvillimet dhe ecurinë e procesit të integritimit. Raporti periodik nr. 1/2017 përfshin zhvillimet dhe ecurinë e procesit të anëtarësimit për periudhën janar – mars 2017.

Raporti është strukturuar sipas çështjeve kryesore të lidhura me procesin e integritimit, dhe përfshin ecurinë e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 28.05.2014 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për 5 Prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian 2013”, zbatimin e Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2016 – 2020, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 74, datë 27.1.2016, miratimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2017 – 2020, zhvillimin e takimeve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian, si dhe menaxhimin e programeve financiare të ndihmës së huaj, përfshirë dhe rritjen e kapaciteteve të administratës lidhur me procesin e integritimit.

Ky raport sjell gjithashtu, në mënyrë të detajuar, informacion mbi përkthimin, rishikimin dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, shkallën e përputhshmërisë së projekt-akteve që paraqiten për mendim pranë MIE-s gjatë periudhës kohore të raportimit, direktivat apo rregulloret e BE-së të përkthyer dhe të rishikuara.

Ecuria e zbatimit të MSA-së

Veprimtaria e organeve monitoruese të procesit të integritimit

Grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull negociues të ngritura mbi bazën e Urdhrit të Kryeministrit Nr. 107, datë 28.02.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integritimin evropian”, u mbledhën rregullisht gjatë këtij tremujori. Takimet e zhvilluara gjatë periudhës janar – mars 2017, u përqendruan në:

- analizën e zbatimit të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2016 – 2020;
- përfundimin e hartimit të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2017 – 2020;
- përgatitjet për takimet e institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian për vitin 2017, etj.

Takimet për monitorimin e zbatimit të MSA

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, u zhvilluan këto takime:

- Takimi i Nënkomitetit Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet, zhvilluar me datë 23 – 24 janar 2017, në Tiranë. Në kuadër të këtij takimi, Ministria e Integrimit Evropian ka përgatitur dhe u ka paraqitur shërbimeve të Komisionit Evropian, minutat e takimit. Gjithashtu, në zbatim të rekomandimeve të palës evropiane, ka filluar mbledhja dhe përpunimi i informacionit të kërkuar nga shërbimet e Komisionit;
- Takimi i Nënkomitetit Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Zhvillimi Rajonal, zhvilluar me datë 30 mars 2017, në Tiranë. Gjatë tremujorit të dytë, Ministria e Integrimit Evropian do të hartojë minutat e këtij takimi, si dhe do të mbledhë dhe përpunojë informacionet shtesë të kërkuara nga shërbimet e Komisionit.

Gjatë tremujorit të parë, përfundoi edhe mbledhja e informacionit plotësues kërkuar nga Komisioni Evropian në kuadër të Nënkomitetit për Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, zhvilluar me 15 nëntor 2016, në Tiranë.

Gjatë tremujorit të parë filluan përgatitjet për takimin e Nënkomitetit Drejtësia, Liria dhe Siguria, i cili është planifikuar të zhvillohet me datë 28 prill 2017, në Bruksel. Si pjesë e këtij takimi, Ministria e Integrimit Evropian koordinoi përgatitjen e informacionit të palës shqiptare. Ky informacion iu paraqit Komisionit Evropian më datë 15 mars 2017.

Ministria e Integrimit Evropian zhvilloi më datë 9 mars 2017 një takim me Komitetin e Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (KKNIE). Në fokus të kësaj mbledhjeje, ishin disa prej problematikave të evidentuara në takimet e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës, raportimet dhe mbledhjet mujore në kuadër të monitorimit të Planit Kombëtar të Integrimit Evropian.

Zbatimi i nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit: Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017 u miratuan një numër aktesh të rëndësishme për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian, si vijon:

- Ligji Nr. 2/2017, datë 26.1.2017 “Për sigurinë kibernetike”, i cili është i përafuar pjesërisht me Direktivën (BE) 2016/1148 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 6 korrik 2016, “Mbi masat për një nivel të përbashkët të lartë të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në Bashkimin Evropian”;
- Ligji Nr. 7/2017, datë 2.2.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili është i përafuar pjesërisht me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE”, të ndryshuar;

- Ligji Nr. 17/2017, datë 16.2.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, i cili është i përafuar pjesërisht me Direktivën 98/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 6 korrik 1998, “Mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike”, Direktivën (BE) 2015/2436 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2015, “Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me markat tregtare”, Rregulloren (BE) 1151/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 nëntor 2012, “Mbiskemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”, Rregulloren (BE) 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 dhjetor 2013, “Përkrijimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KEE) 922/72, (KEE) 234/79, (KE) 1037/2001 dhe (KE) 1234/2007”, të ndryshuar”;
- Ligji Nr. 10/2017, datë 2.2.2017 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen për masat e shteteve portuale për të parandaluar, frenuar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 11.1.2017 “Për miratimin e rregullores “Për kontrollin shtetëror portual në Republikën e Shqipërisë”, i cili është i përafuar plotësisht me Direktivën 2009/16/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 23 prill 2009, “Mbi kontrollin shtetëror portual”, dhe Direktivën 2013/38/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 12 gusht 2013 “Për amendimin e Direktivës 2009/16/KE”;
- Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave Nr. 12, datë 6.1.2017 “Për materiale dhe artikuj plastikë të përcaktuar të jenë në kontakt me ushqimin”, i cili është i përafuar pjesërisht me Rregulloren e Komisionit nr. 10/2011 e 14 janarit 2011 “Mbi materialet dhe artikujt plastikë që mendohet të jenë në kontakt me ushqimin”, amenduar me Rregulloren Implementuese të Komisionit (KE) nr. 321/2011 e 1 prillit 2011;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë 15.2.2017, “Për miratimin e Rregullores “Për mbrojtjen e fëmijëve në punë”, i cili është plotësisht i përafuar me Direktivën e BE 94/33/KE, datë 22 qershor 1994, “Për Mbrojtjen e të Rinjve në Punë”.
- Ligji Nr.15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Zbatimi i këtij ligji do të ndikojë në fuqizimin e bashkëpunimit të komunitetit të biznesit me sistemin e arsimit dhe formimit profesional.
- Ligji Nr. 18/2017 “ Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”ku ndër ndryshimet më të rëndësishme që i janë bërë ligjittëvjetër, janë detyrimi i njësive vendore të ngrenë strukturën e dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve, dhënia e një fuqie vepruese punonjësit social deri edhe për heqjen e të drejtës së prindërimit në raste të veçanta si dhe heqja e përhershme e së drejtës për ushtrimin e profesionit ndaj edukatorëve e mësuesve që përfshihen në çfarëdo lloj rasti dhune ndaj fëmijëve.
- Më datë 16.02.2017 u miratua Ligji Nr.17/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar. Gjithashtu u miratua me dekretin e Presidentit nr. 10059, datë 06.03.2017, shpallja e këtij ligji (17/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar), me qëllim finalizimin e amendimeve të

mëtejshme të ligjit për përafrim me standardet e *acquis*, përmbushjen e detyrave të lëna në raportet e Komisionit Evropian dhe misionet e vëzhgimit, përafrimi me Direktivat e BE-së të dala nga viti 2012 deri 2015 në fushën e pronësisë industriale, si dhe përshtatja e tij me atë të zyrave homologe.

Në kuadër të plotësimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020 janë miratuar edhe këto dokumente strategjike:

- Vendim i Kuvendit të Shqipërisë Nr. 10/2017, datë 09.02.2017 “mbi miratimin e Programit Kombëtar i Statistikave Zyrtare”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 49, datë 25/01/2017 “Mbi miratimin e Programit Kombëtar të Reformave Ekonomike 2017-2019”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 954, datë 30/12/2016 “Mbi miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2017”, i cili parashikonte hyrjen në fuqimë datë 1/01/2017.

Parapërgatitje për procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian

Në datat 17 dhe 18 janar 2017, me kërkesën e Komisionit Evropian, Ministria e Integrimit Evropian zhvilloi dy takime me Znj. Michela Matuella, Përgjegjëse e Njësisë për Shqipërinë në Komisionin Evropian dhe Z. Giulio Venneri, koordinator politik në Njësinë për Shqipërinë në Komisionin Evropian. Në këto takime përfaqësuesit e Komisionit Evropian informuan se Këshilli Evropian vlerëson me konsensus se Shqipëria ka bërë shumë përparim në të gjitha fushat në këto tre vitet e fundit. Për këtë arsye, Këshilli i ka dhënë mandat të qartë politik Komisionit që të vazhdojë angazhimin e tij të veçantë për Shqipërinë. Ky angazhim do të përfshijë edhe përdorimin e disa proceseve teknike të cilat normalisht kryhen vetëm pas hapjes zyrtare të negociatave të anëtarësimit.

Si pjesë e këtij procesi teknik është rënë dakord me Komisionin Evropian zhvillimi i takimeve për njohjen e legjislacionit të Bashkimit Evropian (*pre-screening*) të kapitujve negociues 23 – Drejtësia dhe të drejtat themelore, dhe 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria. Takimi për Kapitullin 23 do të zhvillohet në Bruksel me datë 25 – 26 prill 2017, ndërsa takimi për Kapitullin 24 do të zhvillohet në Bruksel me datë 3 – 5 maj 2017. Në këtë kuadër Ministria e Integrimit Evropian inicioi një takim pranë Ministrisë së Drejtësisë me datë 7 mars dhe një takim pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme me datë 9 mars, me qëllim udhëzimin e ministrive rreth koordinimit të takimeve në Bruksel, modalitetet dhe përzgjedhjen e ekspertëve më të aftë, të cilët do të marrin pjesë në këto takime.

Monitorimi i progresit të arritur në pesë prioritetet kyçe gjatë periudhës janar–mars 2017

Ministria e Integrimit European përfundoi monitorimin e zbatimit të masave të parashikuara në “Planin e Masave për rekomandimet afatshkurtra për vitin 2016” miratuar nga Bordi i Integrimit, një dokument i brendshëm pune i hartuar mbi bazën e rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë i vitit 2015. Nga raporti i monitorimit të Planit të masave, i datës 23 dhjetor 2016, realizimi është në masën 93%.

Bazuar në eksperiencën e mëparshme, Ministria e Integrimit Evropian, në bashkëpunim me Sekretariatit Teknik të Bordit të Integrimit, kanë koordinuar institucionet shqiptare udhëheqëse të punës për plotësimin e pesë prioritetëve kyçe, për të përfunduar hartimin e planit të masave për adresimin e rekomandimeve afatshkurtra të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë i vitit 2016. Masat e planifikuara do të kenë një afat zbatimi deri në fund të vitit 2017 dhe do të kenë mbështetje buxhetore nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e secilës masë. Bashkangjitur do të gjeni një kopje të këtij plani.

Përafrimi dhe përkthimi i legjislacionit

Realizimi i tre-mujorit janar-mars 2017 mbi përafrimin e legjislacionit

Gjatë periudhës janar-mars 2017, në Ministrinë e Integrimit European kanë ardhur për mendim 14 projektakte, ndër të cilat 10 projektligje si dhe 4 projektvendime, për të cilat MIE është shprehur si më poshtë:

Ndër fushat në të cilat ka patur përafrim legjislacioni të plotë:

Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe punësimi

Projektvendimi “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e fëmijëve në punë” me Direktivën 94/33 KE është plotësisht i përputhshëm me Direktivën 94/33 KE “Për mbrojtjen e të rinjve në punë”.

Ndër fushat në të cilat ka patur përafrim legjislacioni të pjesshëm:

Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Projektligji “Për produktet kozmetike” është pjesërisht i përputhshëm me Rregulloren KE nr. 1223/2009 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 30 nëntor 2009, “Për produktet kozmetike”.

Kapitulli 13: Peshkimi

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2012, datë 31.05.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar”, është pjesërisht i përputhshëm me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 1224/2009 e 20 nëntorit 2009, “Për ngritjen e një sistemi Komunitar të kontrollit me qëllim garantimin e përputhshmërisë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit(PPP)”; Rregulloren e (BE) Nr. 2015/2102 që modifikon rregulloren e (BE) Nr.

1343/2011 në lidhje me disa masa për peshkimin në zonën e marrëveshjes së GFCM (Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun) Nenet 16/7 – 16/12); Rregulloren e (BE) Nr. 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 Dhjetorit 2013 e Politikës së Përbashkët për peshkimin si dhe; Vendim zbatimi (BE) 2016/1251 i Komisionit i 12 korrikut 2016 që adopton një program shumëvjeçar të bashkimit për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës për periudhën 2017-2019.

Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura

Projektligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” është pjesërisht i përputhshëm me Direktivën Nr. 2014/60/(BE) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 15 Maj 2014, “Për kthimin e objekteve kulturore të hequra në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar” dhe amendon Rregulloren (BE) Nr. 1024/2012; si dhe me Rregulloren Nr. 116/2009 e Këshillit të Europës datë 18 Dhjetor 2008, “Për eksportin e mallrave kulturore”.

Kapitulli 27: Mjedisi

Projektligji “Për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore industriale, që përfshijnë substanca të rrezikshme” është pjesërisht i përputhshëm me Direktivën 2012/18/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 4 Korrik 2012, “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme”, që shfuqizon Direktivën e Këshillit 96/82/EC.

Projektaktet e vlerësuara dhe shkalla e përafritimit me acquis-në e BE-së

Shkalla e përputhshmërisë	P.ligje	P.vendime	Projekt-marrëveshje	Projekt-udhëzime	Total projektakte
Të papërafuar	3	2			5
Të përafuara pjesërisht	5				5
Të përafuar plotësisht		1			1
Të kthyer për plotësim	1	2			3
Total	10	4			14

Lidhur me rishikimin e përkthimit të legjislacionit gjatë periudhës Janar - Mars 2017

Ministria e Integrimit Evropian:

- ka përfunduar procesin e rishikimit dhe përkthimit të “Programit të bashkëpunimit mesdhetar (MED) 2014-2020”.

- Janë dërguar pranë institucioneve të linjës të gjitha aktet e rishikuara dhe të certifikuara të vitit 2016.
- Kanë ardhur të gjitha kërkesat dhe nevojat e institucioneve të linjës dhe është duke u përpiluar kalendari përfundimtar i nevojave të institucioneve në bazë të PKIE 2017-2020.
- Janë mbajtur takime periodike të Komisionit Teknik për Hartimin e Manualit të përbashkët të termave ligjore.

Gjatë periudhës janar- mars 2017 janë përkthyer materialet si vijon:

Kushtet e Përgjithshme të “IPA II- Interreg V- MED”;

Seksionet 5, 6, 7 dhe 8, si dhe rishikimin e pjesës tjetër të Programit të Bashkëpunimit Territorial Evropian “INTERREG V- MED”;

Materiale për publikim në faqen e internetit të Ministrisë së Integrimit Evropian;

Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjes së Financimit, Programi 'Interreg V-B Balkan-Mediterranean';

Marrëveshja Financiare IPA 2016.

Gjithashtu, janë në proces përkthimi:

Kontrata e Reformës së Sektorit për Luftën Kundër Korrupsionit– Marrëveshja Financiare IPA 2016, e ndryshuar;

Kontrata e Reformës së Sektorit për Mbështetjen e Transportit, me Fokus tek Rrugët- Marrëveshja Financiare IPA 2016, e ndryshuar.

Plani Kombëtar i Integrimit Evropian

Ministria e Integrimit Evropian finalizoi në muajin janar 2017 monitorimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 74, datë 27.1.2016 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020”. Monitorimi final tregoi se nga 197 projektakte ligjore të planifikuara për vitin 2016, ishin miratuar 114 akte ligjore gjatë vitit 2016. Përqindja e realizimit të projektakteve për këtë periudhë ishte 57%. Nga 39 dokumente strategjike apo dokumente politikash të planifikuar për vitin 2016, u miratuan 19 të tillë gjatë vitit 2016. Përqindja e realizimit të dokumenteve strategjike ishte 49%. Realizimi total i PKIE për vitin 2016 ishte 56.4%.

Raporti i monitorimit final të PKIE 2016 – 2020 është i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Integrimit Evropian,

<http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/raporte/dokumente-raporti-i-monitorimit-te-pkie-2016-2020-janar-dhjetor-2016&page=1>.

Në tetor 2016, Ministria e Integrimit Evropian inicioi hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020. PKIE 2017 – 2020 u hartua me të njëjtën metodologji si PKIE 2016 – 2020. Për këtë qëllim, Ministria e Integrimit Evropian udhëzoi ministrinë e linjës mbi procedurat dhe formatin e PKIE 2017 – 2020. Në PKIE 2017 – 2020 u pasqyruan

edhe rekomandimet e Raportit të Komisionit për Shqipërinë për vitin 2016 dhe rekomandimet e takimeve të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. PKIE 2017-2020 u konsultua gjerësisht me grupet e interesit (shih Raportin e 3 mujorit të fundit të vitit 2016 depozituar në Kuvend).

Hartimi i PKIE 2017 – 2020 u finalizua në dhjetor 2016. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 25.1.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020”.

PKIE 2017 – 2020 përmban në total, 147 akte ligjore dhe dokumente strategjike për miratim gjatë vitit 2017. Monitorimi i zbatimit të PKIE 2017 – 2020 do të kryhet sipas të njëjtës metodologji të përdorur edhe për monitorimin e PKIE 2015 – 2020 dhe 2016 – 2020.

Gjatë muajit janar 2017, Ministria e Integritimit Evropian kontribuoi në arritjen e përputhshmërisë mes Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020 dhe Programit Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2017.

Krahasimi i PKIE 2015 – 2020, 2016 – 2020 dhe 2017 – 2020

Krahasimi i të dhënave të Planeve Kombëtare për Integrimin Evropian, tregon se numri i akteve të planifikuara për miratim ka ardhur në rënie nga viti 2015 deri në vitin 2017. Të njëjtin trend vërejmë edhe në lidhje me dokumentet strategjike të planifikuar.

Por, nga ana tjetër vërejmë se numri i akteve ligjore apo dokumenteve strategjike të miratuar ka mbetur pothuajse i njëjtë.

Në tërësi, përqindja e realizimit të Planit është rritur në periudhën 2015 – 2016, nga rreth 47% në rreth 56%. Kjo dëshmon një planifikim më të saktë dhe realist të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

PKIE	Nr. akte plan	Nr. akte miratuar	%	Nr. dok. strat. plan	Nr. dok. strat. miratuar	%	Totali %
2015 – 2020	243	120	50	51	19	37	47
2016 – 2020	197	114	57	39	19	49	56
2017 – 2020	116			31			

Forcimi i kapaciteteve institucionale

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme për forcimin e kapaciteteve institucionale:

- Workshop “Mbështetje për Forumin e Investimeve të Dhomave të Tregtisë së Ballkanit Perëndimor për Prokurimet Publike”, organizuar nga TAIEX, në Beograd, Serbi, datë 30 – 31 janar 2017;
- Trajnim mbi “Harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me *acquis* të BE-së dhe përmirësimin e klimës në tërheqjen e investitorëve, sezoni i dytë”, organizuar nga GIZ, në Tiranë, Shqipëri, më datë 21 – 23 Shkurt 2017;
- Workshop “Identifikimi i rreziqeve emergjente në fushën e sigurisë ushqimore”, Zaragosa, Spanjë, datë 7-8 Mars 2017
- Workshop “Mbështetje për Forumin e Investimeve të Dhomave të Tregtisë së Ballkanit Perëndimor për aksesin e NVM në financime”, organizuar nga TAIEX, në Podgoricë, Mali i Zi, datë 27 – 28 mars 2017;
- Seminar parlamentar mbi “Lirinë e shprehjes në media”, organizuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, në Tiranë, datë 24 shkurt 2017.
- Trajnim për përdorimin e Sistemit të Raportimit të PAR në kuadër të reformës së administratës publike, organizuar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në Tiranë, datë 26 janar 2017.
- Workshop në “Specializimi Smart RIS-3 dhe Inovacion përmes pjesëmarrjes së IAL-ve, Sektorit të Biznesit dhe Qeverisë”, organizuar nga TAIEX në bashkëpunim me MAS, Tiranë, më datë 20 dhjetor 2016.
- Multicountry Workshop “Mbështetje për Forumin e Dhomave të Tregëtisë dhe Investimeve në Ballkanin Perëndimor në fushën e Prokurimeve Publike”, organizuar nga TAIEX, Dhoma e Tregëtisë Terazije, Beograd, datë 30-31 janar 2017.

Aktivitete të tjera

Në kuadër të hartimit të Programit të Reformës Ekonomike 2017 – 2019, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes organizoi në Tiranë, me datë 11 janar 2017 një takim me donatorë të huaj.

Në vijim të takimit të mësipërm, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Programit të Reformës Ekonomike, me datë 1 shkurt 2017, u zhvillua në Tiranë një takim të organizuar me përfaqësues të Komisionit Evropian, ku u bë një vlerësim paraprak i Programit të Reformës Ekonomike 2017 – 2019.

Me 25 janar 2017, u zhvillua me mbështetjen e GIZ në Podgoricë, Mal i Zi, konferenca “Raportet e Komisionit për vendet candidate – Reformat e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor”. Kjo konferencë u përqendrua në hartimin e kontributeve të shteteve candidate dhe candidate potenciale për raportet vjetore dhe strategjinë e zgjerimit të Komisionit. Gjithashtu, u diskutua edhe mbi progresin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Procesin e Berlinit, në parapërgatitje të Samitit të Triestes.

Gjatë muajit mars, u zhvilluan dy takime të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, të organizuar nga Ministria e Mjedisit. Këto takime kishin si qëllim diskutimin e

propozimeve të anëtarëve të Komitetit si dhe miratimin e Planit imediat të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Bashkëpunimi Territorial

Në cilësinë e saj si Autoritet Kombëtar për Bashkëpunim Territorial, Ministria e Integritimit Evropian, ka punuar ngushtësisht me strukturat homologe për të mundësuar zbatimin e Programeve Ndërkufitare dhe Transnacionale në të cilat vendi ynë merr pjesë gjatë perspektivës IPA II. Një rëndësi e veçantë, gjatë këtij tre mujori, i është kushtuar nënshkrimit të Marrëveshjeve të Financimit, hartimit dhe shpalljes së thirrjeve për projekt propozime, si dhe vlerësimit të tyre.

Programi IPA CBC Shqipëri-Kosovë 2014-2020 – në kuadër të këtij programi u shpall thirrja e parë për projekt-propozime në datë 11 janar 2017, e cila qëndroi e hapur deri në datë 16 Mars 2017, me një buxhet prej rreth 2.1 Mln EUR (kontribut i BE). Me qëllim përcjelljen e informacionit tek aktorët e interesuar, Ministria e Integritimit Evropian, në bashkëpunim me strukturat homologe kosovare dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian organizoi 4 sesione informuese (dy për çdo vend) dhe dy trajnime për përfituesit potencialë. Zyra e Sekretariatit të Përbashkët Teknik me seli në Kukës është tashmë e plotësuar me stafin përkatës dhe tërësisht funksionale.

Në kuadër të ***Programit IPA CBC Maqedoni-Shqipëri 2014-2020***, më datë 30-31 Janar 2017 u organizua në Strugë takimi i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (JMC) i këtij programi, si dhe një trajnim i dedikuar për anëtarët e komitetit me qëllim rritjen e kapaciteteve. Në kuadër të këtij programi është shpallur një thirrje për projekt propozime, nga faza e parë e së cilës (faza e aplikimit me koncept-notë) janë përzgjedhur 21 projekte për të kaluar në fazën e dytë të aplikimit (*aplikimi i plotë*). Faza e dytë e aplikimit u shpall më 20 shkurt 2017 dhe qëndroi e hapur deri më datë 20 Mars 2017. Me qëllim udhëzimin sa më të saktë të përfituesve lidhur më këtë fazë të dytë, Delegacioni i BE në Shkup, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, në bashkëpunim me Strukturat Operuese të Maqedonisë dhe Shqipërisë, organizuan një sesion informues, më 20 shkurt, në Strugë.

Programi IPA CBC Mali i Zi-Shqipëri – gjatë periudhës janar – mars 2017 është proceduar për mbylljen e vlerësimit të projekteve të thirrjes së parë për propozime (*faza e parë-konceptnotë*) dhe brenda muajit mars u janë dërguar njoftime aplikantëve të përzgjedhur për të aplikuar për fazën e dytë (*aplikimi i plotë*).

Programi Trilateral Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi – Thirrja e parë për projekt propozime (me vlerë 25 Milion Euro) në kuadër të këtij Programi është shpallur në 16 mars 2017 dhe do të qëndrojë e hapur për një periudhë 60 ditore, deri në 15 maj 2017. MIE ka organizuar një konferencë në Tiranë, me datë 15 mars 2017, për prezantimin e këtij programi

dhe për lançimin e thirrjes së parë për projekte. Konferenca u adresua nga Ministria e Integrimit Evropian dhe Ambasadori i Italisë në Shqipëri. Marrëveshja e Financimit për këtë Program është nën shkruar në kohë.

Programi Interreg IPA CBC Greqi-Shqipëri – MIE ka ndjekur procesin e vlerësimit të projekt propozimeve të thirrjes së dytë për projekte nga e cila pati një numër relativisht të lartë projektesh të dorëzuara (200 në total). Pritet që ky proces të mbyllet brenda muajit maj 2017, për të vijuar më pas me procedurën e nënshkrimit të kontratave me përfituesit. Ndërkohë, kontratat me projektet fituese të Thirrjes së Parë, pritet të nënshkruhen gjatë muajve prill-maj 2017.

Përsa i përket Programit **Interreg ADRION** mund të përmendim se pas mbylljes së Thirrjes së Parë për Propozime u vu re një përfshirje e lartë e përfituesve shqiptarë. Në këtë thirrje janë përfshirë 2983 aplikantë, nga të cilët 262 aplikantë nga Shqipëria, numri më i lartë krahasuar me vendet e rajonit. Projekt-propozimet janë në proces vlerësimi, i cili pritet të përfundojë në maj 2017. Në lidhje me Marrëveshjen e Financimit për këtë Program, ajo pritet të nënshkruhet brenda prillit 2017 ndërsa projektet fituese të thirrjes së parë mendohet të lidhin kontratat e financimit në qershor 2017.

Lidhur me **Programin Interreg Ballkan-Mediterranean**, në datë 9 mars në Qipro, u organizua takimi i Komitetit të Përbashkët Monitorues i këtij programi, i cili miratoi listën prej 37 projektesh të përzgjedhura për financim, të cilat do t'i nënshtrohen procesit nënshkrimit të kontratave përkatëse. Në këto projekte ka një numër të madh partnerësh shqiptarë krahasuar me vendin tjetër IPA pjesëmarrës në Program (Maqedoninë) Procedura për miratimin e Marrëveshjes së Financimit për këtë Program është mbyllur dhe pritet dërgimi i kopjeve të firmosura pranë Autoritetit Menaxhues në Greqi për t'u përcjellë më pas në Komisionin Evropian. Staf i Sekretariatit të Përbashkët Teknik nuk është përzgjedhur ende, por Autoriteti Menaxhues është në proces selektimi.

Programin Interreg Mesdheu (MED), më 30 Janar 2017 shpalli thirrjen e dytë për Projekt Propozime Modulare, e cila do të qëndrojë e hapur deri më datë 31 Mars 2017. Në kuadër të kësaj thirrjeje Ministria e Integrimit Evropian, më 16 Shkurt 2017, organizoi në ambientet e saj një Ditë Informimi më përfituesit potencial, për ti informuar më shumë në lidhje me modalitetet e thirrjes. Përsa i përket Marrëveshjes së Financimit të këtij programi, aktualisht ajo është në proces certifikimi dhe parashikohet të nënshkruhet brenda muajit Prill 2017. Ndërkohë, nga thirrja e parë për projekt propozime mund të themi se janë lidhur kontratat e financimit, ku vërehet një numër tejet i kënaqshëm partnerësh nga Shqipëria, duke lënë pas vendet e tjera IPA pjesëmarrëse në program si Mali i Zi dhe Bosnja.

IPA Kombëtare

Amendimi i Marrëveshjes së Financimit për Programin IPA 2013

Për sa i përket Programit të Veprimit IPA për vitin 2013, Këshilli i Ministrave ka miratuar në parim shtesën nr. 1 dhe shtesën nr. 2 të Marrëveshjes në fjalë me VKM Nr. 937, datë 28.12.2016, si dhe është nënshkruar nga KKIPA në datë 30.12.2016.

Data përfundimtare për lidhjen e kontratave të prokurimit dhe dhënies së grantit është 3 vjet nga data e lidhjes së Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve të listuara/renditura në Nenin 189(2), të Rregullores Financiare.

Amendimi i Marrëveshjes së Financimit për Programin IPA 2009

Në vijim të rishikimit mbi ecurinë e projektit IPA 2009 N°.12 në lidhje me ndërtimin e infrastrukturave të ujësjellës dhe kanalizimeve në Kamëz, Kavajë, Lezhë / Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë/Ksamil, si dhe pas konsultimeve me ministrinë e linjës dhe institucionet përkatëse zbatuese, gjatë muajit mars 2017, është kërkuar një ndryshim jo – thelbësor në Vendimin dhe në Marrëveshjen e Financimit që rregullon Programin Kombëtar IPA 2009 për Shqipërinë. Shtyrja e afatit të zbatimit për projektin e lart përmendur është thelbësore në mënyrë që projekti dhe infrastruktura e ndërtuar të përfundojnë me sukses.

Procesi i programimit të IPA 2016

Ashtu sikurse jeni vënë në dijeni, paketa e Programit IPA 2016 përfshin këto dokumente veprimesh, potenciale për të përfituar nga ky Program:

1. Mbështetje buxhetore për Antikorrupsionin–10 milionë EUR;
2. Mbështetje buxhetore për Transportin (mirëmbajtje rrugore) – 24 milionë EUR;
3. Fondi i BE-së për integrimin (EU integration facility) – 4.74 milionë EUR;
4. Konsolidimi i sistemit të drejtësisë në Shqipëri - (Mbështetje për EURALIUS me 7.5 mln EUR dhe Vetting 5 mln EUR);
5. Sektori i ujit – 4 milionë EUR (TA);
6. Siguria ushqimore – 5 milionë EUR (TA);
7. Peshkimi – 3,7 milionë EUR (TA).

Gjatë muajve janar- shkurt ka vijuar procesi i rishikimit dhe saktësimit të indikatorëve për dy Kontratat e Reformës Sektoriale në sektorët e Transportit dhe Antikorrupsionit. Janë zhvilluar disa takime konsultuese mes institucioneve lider (MTI dhe MSHCV), MIE dhe DBE, duke u finalizuar me përcaktimin e indikatorëve finale të dy AD-ve të lart përmendura.

Duke konsideruar kohën që nevojitej për finalizimin e indikatorëve, KKIPA është ende në pritje të dërgimit të Marrëveshjes përkatëse Financiare nga Komisioni European, për kalimin e procedurave të brendshme dhe më tej për nënshkrim nga KKIPA. Kjo Marrëveshje Financiare mendohet të firmoset nga KKIPA brenda gjashtë mujorit të parë të këtij viti.

Procesi i programimit të IPA IPA 2017

Vijon procesi i programimit të fondeve për IPA 2017, sipas kalendarit të ri-dërguar nga Shërbimet e DBE-së në Tiranë.

Duke filluar nga muaji shtator 2016 e deri në fund të muajit qershor 2017, të tre institucionet lider për Sektorët e (i) Drejtësisë, (ii) Ujit, si dhe (iii) Konkurrueshmërisë dhe Inovacionit, kanë vijuar të marrin mbështetjen nga ekspertët e përzgjedhur nëpërmjet një kontrate nga DBE, me qëllim rishikimin dhe hartimin e AD-ve përkatëse.

Gjatë muajit shkurt 2017 është punuar mbi draft-Dokumentet e Veprimit për të gjitha AD-të, potenciale për të përfituar nga ky program dhe janë organizuar takime konsultuese dhe workshope midis DBE-së, MIE dhe Institucioneve përfituese.

Draftet e para të Dokumenteve të Veprimit janë dërguar pranë Komisionit Europian në fund të muajit shkurt 2017, pas reflektimit të komenteve të DBE-së nga institucionet përfituese.

Gjithashtu, në kuadër të përfshirjes së grupeve të interesit, gjatë procesit të programimit të fondeve IPA, në datën 30 mars dhe 4 prill 2017, do të organizohen 2 raunde konsultimesh me donatorët e huaj dhe shoqërinë civile, ku do të bëhet prezantimi dhe konsultimi i draft programeve që do të përfitojnë nga Programimi IPA 2017-2018.

Në këtë kuadër, pas dërgimit të draftit të rishikuar të Dokumentit Strategjik Kombëtar 2014 - 2020, gjatë takimeve konsultative do të kërkohet opinioni i grupeve të interesit edhe për këtë Dokument Strategjik.

Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF): Në kuadër të thirrjes së 17të të WBIF Zyra mbështetëse e KKIPA ka koordinuar/asistuar gjatë procesit të plotësimit të formularëve të aplikimit për asistencë teknike si dhe ka paraqitur zyrtarisht projekt-propozimet e mëposhtme për Asistencë Teknike:

1. Modeli financiar dhe i biznesit për zhvillimin e hidrocentralit të Skavicës, studimi i fizibilitetit duke përfshirë Studimin e Impaktit Mjedisor dhe Social, dizajni i detajuar dhe dokumentat e tenderit;
2. Përgatitje për studimin e fizibilitetit dhe Studimin e Impaktit Mjedisor, për të mundësuar zhvillim të qëndrueshëm në një mënyrë ekologjike dhe duke mbrojtur burimet natyrore në Liqenin e Shkodrës;
3. Dizajni i detajuar për mbrojtje nga përmbytjet në lumenjtë Drin dhe Buna;
4. Përditësimi i dizajnit të projektit për institucionin për të burgosurit me sëmundje mendore dhe analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve;
5. Studimi i fizibilitetit për rindërtimin e kalatave 1 & 2 në Portin e Durrësit;
6. Studimi i fizibilitetit dhe dizajni i detajuar për projektin e By-passit të Lezhës.

Në Komitetin Drejtues të WBIF i cili do të mbahet në qershor 2017, do të vendoset nëse këto projekte do të mbështeten nga BE.

Programet Europiane: Gjatë periudhës janar-mars 2017, MIE në bashkëpunim me Asistencën Teknike për Programet Europiane, ka vazhduar me zhvillimin rreth 10 trajnime për programet Horizon 2020, Europa Krijuese, Europa për Qytetarët dhe EaSI.

Monitorimi i projekteve IPA në zbatim

Gjatë periudhës së raportimit u shfaqën përsëri një numër i vogël çështjes të cilat kanë ndikim mbi ecurinë e disa prej projekteve nën menaxhim të centralizuar. Çështjet në fjalë po ndiqen nga Sektori i Monitorimit të projekteve të BE-së në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues (Delegacioni i BE-se, Tiranë) me qëllim sigurimin e ecurisë normale të tyre, sipas planit të aktiviteteve.

Referuar projekteve nën menaxhim të decentralizuar, performanca e tyre deri tani paraqitet në përgjithësi e mirë, me ndonjë përjashtim, të cilat janë normale duke qenë se sistemi i menaxhimit të decentralizuar është në periudhë konsolidimi - çështje të cilat po adresohen falë bashkëpunimit mes Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (KKIPA/MIE), Autoritetit Kontraktues (MF) dhe institucionit përfitues të projektit. Gjatë periudhës së raportimit nuk janë paraqitur çështje madhore problematike referuar projekteve të decentralizuara.

Në kuadrin e programeve të mbështetjes buxhetore për (i) Reformën në Menaxhimin e Financave Publike (ii) Reformën në Administratën Publike dhe (iii) Punësimin, planet e aktiviteteve bazuar në strategjitë përkatëse të reformave janë duke u zbatuar, ndërsa nuk ka zhvillime të reja në aspektin financiar (miratim/lëvrim të transheve të tjera), megjithatë kërkesa (së bashku me raportet përkatëse) për lëvrimin e transhit të dytë të mbështetjes buxhetore për Reformën në Administratën Publike është drejt finalizimit.

Në 18 janar 2017, në Tiranë, u mbajt Komiteti i Monitorimit të IPA-s ku u diskutuan zhvillimet e ndihmës financiare IPA për periudhën 2015-2016 dhe u diskutuan prioritetet për vitin e ardhshëm të zbatimit të asistencës financiare të BE-së. Gjatë këtij takimi u vlerësua progresi shumë i mirë i institucioneve shqiptare në adresimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të takimit pararendës të Monitorimit të IPA-s, veçanërisht në zgjidhjen e çështjeve problematike të projekteve në zbatim si dhe progresit të stafit të institucioneve tona lidhur me adoptimin e metodologjisë së IPA II të bazuar në qasjen sektoriale. Komisioni theksoi rëndësinë që duhet t'i jepet në vijim sigurimit të vizibilitetit të projekteve të financuara nga BE dhe kërkoi angazhimin e palës shqiptare lidhur me këtë.

Referuar procesit të akreditimit të sistemit të menaxhimit indirekt të fondeve të IPA II, është ende në proces adresimi i një pjese të vogël të mbetur të gjetjeve dhe rekomandimeve të misioneve të auditimit të Komisionit European lidhur me marrjen e besimit për menaxhimin indirekt të programeve IPA 2014 dhe 2015, si dhe rekomandimeve të misionit të Komisionit European për sistemin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Përtej kësaj, një tjetër mision auditimi nga ana e Komisionit European u mbajt në Shqipëri në datat 27 Shkurt – 3 Mars 2017, me qëllim verifikimin e situatës dhe vlerësimin e progresit, kështu, situata do të jetë më e qartë pas dërgimit të raportit përkatës. Megjithatë, paralelisht po vijon implementimi i projekteve nën këto programe.

Gjithashtu, pas dërgimit të raportit paraprak të misionit të auditimit të DG-Agri, në vijim të aplikimit nga ana e autoriteteve Shqiptare dhe misionit të verifikimit – për zbatimin e Programit të Asistencës së Zhvillimit Rural (IPARD II) – NAO/ZKA (si autoriteti përgjegjës për akreditimin), po vijon punën për përgatitjen e planit të veprimit për adresimin e gjetjeve dhe/ose rekomandimeve, koordinimin me aktorët përkatës për dërgimin e observimeve/komentet mbi draft-gjetjet/rekomandimet e raportit, me qëllim hartimin e raportit final nga ana e DG- Agri.

Gjatë tremujorit të parë 2017, stafi i MIE-s dhe institucioneve të tjera zbatuese të fondeve IPA II ka ndjekur një seri aktivitesh trajnuese, bazuar në planin për ngritjen e kapaciteteve administrative të vendit përfitues IPA, në kuadrin e fazës së dytë - IPA II 2014-2020.

PLANI I MASAVE PËR REKOMANDIMET AFATSHKURTRA

PRIORITETI 1 - REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Rekomandim 1: Të bëhet përputhja e buxhetit vjetor me PBA (programin buxhetor afat-mesëm), me strategjitë në vazhdim të reformës, si dhe me prioritetet e qeverisë					
	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Komente
1.	Përputhja e buxhetit vjetor me PBA (programin buxhetor afat-mesëm), me strategjitë në vazhdim të reformës, si dhe me prioritetet e qeverisë				
	1.1. Diskutimi paraprak i PBA (Faza e Parë) 2018 – 2020 në Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike.	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike Departamenti i Programit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj	Mars 2017		
	1.2 Përgatitja e kërkesave buxhetore nga institucionet në linjë me strategjitë në sektorin e Reformës së	Departamenti i Programit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj	Maj 2017		

	<p>Administratës Publike dhe prioritetet e qeverisë.</p>	<p>Të gjitha institucionet që kanë aktivitete në strategjitë nën sektorin e PAR.</p> <p>Ministria e Financave</p>			
	<p>1.3 Dërgimi i kërkesave buxhetore pranë Ministrisë së Financave nga të gjithë institucionet përgjegjëse</p>	<p>Të gjitha institucionet që kanë aktivitete në strategjitë nën sektorin e PAR.</p> <p>Ministria e Financave</p>	<p>1 Maj 2017</p>		
	<p>1.4 Miratimi i fazës së parë të PBA me Vendim të Këshillit të Ministrave</p>	<p>Propozim i Ministrisë së Financave dhe miratimi i VKM nga Këshilli i Ministrave.</p>	<p>28 Qershor 2017</p>		
	<p>1.5 Fillimi i procesit për përgatitjen e kërkesave të rishikuara buxhetore nga institucionet, dërgimi pranë Ministrisë së Financave të kërkesave, kryerja e analizave të kërkesave të rishikuara buxhetore nga MF, si dhe miratimi i Projektbuxhetit të vitit 2018 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2018-2020</p>	<p>Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike Të gjitha institucionet që kanë aktivitete në strategjitë nën sektorin e PAR.</p> <p>Ministria e Financave Departamenti i Programit të Zhvillimit, Financimeve dhe</p>	<p>10 Korrik 2017 – 20 Tetor 2017</p>		

Ndhmës së Huaj					
Rekomandim 2: Të forcohen kapacitetet e Menaxherëve të Burimeve Njerëzore dhe Pjesëtarëve të Komitetit të Përzgjedhjes, për përmirësimin e procesit të rekrutimit; dhe të mundësohet shkëmbimi i të dhënave midis HRMIS dhe Thesarit					
	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Komente
1.	Forcimi i kapaciteteve të Burimeve Njerëzore				
	1.1 Finalizimi i Modullit të Ri të Trajnimit për Burimet Njerëzore	ASPA/DAP/Projekti i Binjakëzimit IPA 2012 (Twinning Project)	Prill 2017		
	1.1.2 Nisja e trajnimeve të para për nëpunësit në sektorët e burimeve njerëzore sipas Modullit të Trajnimit të hartuar në bashkëpunim me ASPA dhe Projektin e Binjakëzimit	ASPA/DAP (Projekti i Binjakëzimit IPA 2012)	Mars 2017- Vazhdim		
2.	Forcimi i kapaciteteve të pjesëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit	MIAP DAP Projekti i Binjakëzimit IPA 2012	Prill 2017		
	2.1 Trajnimi i anëtarëve të KKP	DAP Projekti i Binjakëzimit IPA 2012	Prill- Qershor 2017		
3.	Mundësimi i shkëmbimit të të dhënave midis HRMIS dhe Thesarit	MIAP DAP Ministria e Financave Institucionet e tjera	Dhjetor 2017		
	3.1. Miratimi i udhëzimit të përbashkët mbi formatin	MIAP/DAP Ministria e Financave	13 Dhjetor 2016		

	standard të borderosë				
	3.2 Zbatimi i udhëzimit Pikat 3.2.1,3.2.2 dhe 3.2.3 të udhëzimit detajojnë hapat që do të ndërmerren me qëllim që të sigurohet zbatimi i Udhëzimit në mënyrën e duhur.	MIAP/DAP Ministria e Financave Të gjitha institucionet e administratës publike	Mars 2017		
	3.2.1 Hartimi i planit të trajnimit për nëpunësit në njësitë e financës në institucionet e administratës publike	MIAP/DAP	Shkurt 2017		
	3.2.2 Hartimi i grafikut sipas të cilit institucionet do të prodhojnë borderonë e pagës nëpërmjet HRMIS.	MIAP/DAP	Shkurt 2017		
	3.2.3 Përdorimi i formatit standard të borderosë së pagës nëpërmjet HRMIS sipas grafikut	Të gjitha institucionet sipas grafikut	Mars-Dhjetor 2017		
	3.3 Përdorimi i formatit të borderosë nga të gjitha institucionet	Të gjitha institucionet	Mars-Dhjetor 2017		

Rekomandim 3: Të kompletohet përafrimi i legjislacionit përkatës me Kodin e Procedurave Administrative dhe të miratohen aktet përkatëse nën ligjore që sigurojnë zbatimin efektiv të tij

	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Komente
1.	Të kompletohet përafrimi i				

	legjislacionit përkatës me Kodin e Procedurave Administrative				
	1.1. Analiza e <i>'Ligjit për Inspektimin'</i> nga ekspertet e Projektit të Binjakëzimit	DAP/ Projekti i Binjakëzimit IPA 2012	29 Janar 2016		
	1.1.2 Hartimi i një metodologjie mbi vlerësimin e përputhshmërisë së ligjeve të ndryshme me Kodin e Ri të Procedurave Administrative.	DAP/Projekti i Binjakëzimit IPA 2012 Ministria e Drejtësisë	Prill 2017		
	1.1.3. Ofrimi i trajnimeve për zbatimin e saktë të Kodit të Procedurave Administrative nëpërmjet Modullit të Trajnimit	DAP/ Projekti i Binjakëzimit IPA 2012 ASPA	Prill 2017		
	1.1.4 Përgatitja e materialeve shpjeguese për publikun e gjerë lidhur me zbatimin e disa prej parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative	Projekti i Binjakëzimit IPA 2012 Ministria e Drejtësisë	Prill 2017		
2.	Miratimi i akteve përkatëse nën ligjore që sigurojnë zbatimin e Kodit të Procedurave Administrative				
	2.1 Hartimi dhe miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave <i>"Për organet publike, procedurat</i>	MIAP	Prill 2017		

<p><i>administrative dhe kërkesat teknike për paraqitjen e kërkesave në organet publike me mjete elektronike”, në zbatim të Nenit 59/7 të Kodit të Proceduarve Administrative</i></p>				
<p>2.2 Hartimi dhe miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për veprimtaritë ekonomike që ofrohen për në pikat e shërbimit me një ndalesë” në zbatim të Nenit 76/3 të Kodit të Proceduarve Administrative</p>	<p>MIAP</p>	<p>Prill 2017</p>		

PRIORITETI 2 - SISTEMI GJYQËSOR

Rekomandim 1: Implementimi i ndryshimeve kushtetuese duke përfshirë miratimin dhe zbatimin e legjislacionit relevant.

Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problematika
<p>1. Hartimi dhe miratimi i paketës së 27 projektligjeve në kuadër të reformës në drejtësi:</p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		
<p>1.1 Projektligji “Për disa</p>	<p>Kuvendi i</p>	<p>Brenda vitit</p>		

<p><i>shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.</i></p>	<p>Shqipërisë</p>	<p>2017</p>		
<p><i>1.2 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		
<p><i>1.3 Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		
<p><i>1.4 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr .8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”.</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		
<p><i>1.5 Projektligji “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”.</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		

<p><i>1.6 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar”.</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		
<p><i>1.7 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 04.12.2003 “për përgjimin e komunikimeve elektronike”, i ndryshuar”.</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		
<p><i>1.8 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, i ndryshuar”</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		
<p><i>1.9 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		

<i>krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë</i>				
<i>1.10 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 157/2013 “Për Masat kundër Financimit të Terrorizmit”</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.11 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.12 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, ndryshuar”</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.13 Projektligji “Për disa</i>	Kuvendi i	Brenda vitit		

<p><i>shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.</i></p>	<p>Shqipërisë</p>	<p>2017</p>		
<p><i>1.14 Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar”.</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		
<p><i>1.15 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar”.</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		
<p><i>1.16 Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”.</i></p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p>	<p>Brenda vitit 2017</p>		

<i>1.17 Projektligji “Për Presidentin e Republikës së Shqipërisë”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.18 Projektligji “Për provimin e shtetit për profesionin e juristit”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.19 Projektligji “Për Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.20 Projektligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.21 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, ‘Për Avokaturën e Shtetit’.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.22 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		

<i>1.23 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.24 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 031, datë 11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.25 Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.26 Projektligji “Për ndihmën juridike”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
<i>1.27 Projektligji “Për tarifat dhe shpenzimet gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.</i>	Kuvendi i Shqipërisë	Brenda vitit 2017		
Rekomandim 2: Ndjekja e reformës sektoriale në kuadër të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020 dhe planit të veprimit, duke u siguruar që burime të mjaftueshme financiare janë vazhdimisht në dispozicion për arritjen e objektivave të reformës				
Masa	Institucioni	Afati	Realizimi	Komente

	pergjegjes			
1.Rishikimi dhe miratimi i strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë dhe planit të veprimit	Ministria e Drejtësisë			
1.1 Ngritja e grupit të punës për rishikimin e strategjisë	Ministria e Drejtësisë	Mars 2017		
1.2 Rivlerësimi i nevojave të aktorëve të sistemit të drejtësisë	Ministria e Drejtësisë	24 Mars 2017		
1.3 Rishikimi i strategjisë dhe planit të veprimit	Ministria e Drejtësisë	21 Prill 2017		
1.4 Buxhetimi i draftit të rishikuar të strategjisë dhe planit të veprimit	Ministria e Drejtësisë	24 prill -26 maj 2017		
1.5 Konsultim publik i draftit të rishikuar të strategjisë dhe planit të veprimit	Ministria e Drejtësisë	1- 26 maj 2017		
1.6 Dërgimi për mendim dhe marrja e mendimeve nga ministritë e linjës dhe institucionet e sistemit të drejtësisë	Ministria e Drejtësisë	15 – 26 maj 2017		
1.7 Tryezë e rumbullakët me	Ministria e	22 maj 2017		

grupet e interesit	Drejtësisë			
1.8 Përgatitja e draftit final dhe dërgimi i draftit në Këshillin e Ministrave për miratim	Ministria e Drejtësisë	29 maj 2017		
1.9 Miratimi në Këshillin e Ministrave	Ministria e Drejtësisë	7 qershor 2017		

Rekomandim 3: Krijimi i organeve të verifikimit (vetingut) dhe nxjerrja e rezultateve fillestare në procesin e ri-vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Komente
1. Ushtrimi nga Institucioni i Avokatit të Popullit i funksioneve që parashikohen në Kushtetutë dhe në ligjin Nr. 84/2016 lidhur me krijimin e organeve të verifikimit (vettingut).	Avokati i Popullit	2017		
2. Ushtrimi i funksionit zgjedhës të Kuvendit për plotësimin e vendeve vakante në institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar procedurat dhe afatet e parashikuara në Kushtetutë,	Kuvendi i Shqipërisë	2017		

ligjin Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 111 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë				
3. Nxjerrja e rezultateve fillestare në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.	Organet e verifikimit (vetingut)	2017		

PRIORITETI 3: LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Rekomandim 1: Të tregojë progres të mëtjshëm në ngritjen e një historiku solid të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet, përfshirë rikuperimin e aseteve; sigurimin e hetimeve të mirëfillta dhe ndjekjen penale të rasteve të referuara në prokurori nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit

	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problemtika
1.	Përmirësimi i kuadrit ligjor për forcimin e regjimit të	ILDKPKI, Kuvendi	Mars 2017		

	deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave				
	1.1 Hartimi i ndryshimeve ligjore në Ligjin Nr. 9049/2003 i ndryshuar “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”	ILDKPKI, Kuvendi	Janar		
	1.2 Konsultim publik i projektligjit me palët e interesuara	ILDKPKI, Kuvendi	Janar		
	1.3 Kalimi i projektligjit në procedurë parlamentare	ILDKPKI, Kuvendi	Shkurt		
	1.4 Miratimi i Projektligjit në Kuvend	Kuvendi	Mars		
2.	Popullimi i sistemit elektronik me statistika mbi regjistrimin dhe gjurmimin e të dhënave mbi rastet e korrupsionit	MSHCV dhe institucione bashkëpunuese: Kryeministria, të gjitha Ministrinë, DPD, DPT, ZRPP, AKKP, APP, NJKBA, SHÇBA, Policia, ILDKPKI, Prokuroritë,	Gusht 2017		

		Gjykatat			
4	Përmirësimi i efencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)			
	4.1 Rritja e numrit të operacioneve me përdorimin e teknikave speciale të hetimit me të njëjtën periudhë të një viti më parë.	DPPSH	Janar–Gusht 2017		
	4.2 Rritja e numrit të hetimeve proaktive për korrupsion me të njëjtën periudhë të një viti më parë.	DPPSH	Janar–Gusht 2017		
Rekomandim 2: Të amendojë legjislacionin për përgjimet dhe mbikëqyrjen, afatet për hetimet dhe pranueshmërinë e provave para gjykatave për të bërë më efikase hetimet në rastet e korrupsionit, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane					
	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problematika
1.	Hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.	Kuvendi	Brenda vitit 2017		
	1.1 Shqyrtimi në komisione parlamentare dhe në seancat plenare	Kuvendi	Brenda vitit 2017		

	1.2 Miratimi i Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.	Kuvendi	Brenda vitit 2017		
Rekomandim 3: Të amendojë kuadrin ligjor për financimin e partive politike, të ngrejë një sistem kontrolli efektiv dhe të besueshëm					
	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problematika
1.	Hartimi dhe miratimi i amendimeve të Kodit Zgjedhor dhe ligjit “Për partitë politike” lidhur me financimin e partive politike.	Kuvendi	Maj 2017		
	1.1 Hartimi i draftit për rishikimin e Kodit Zgjedhor dhe ligjit “Për partitë politike”	Kuvendi	Maj 2017		
	1.2 Miratimi i draftit	Kuvendi	Maj 2017		
2.	Ngritja e strukturës së specializuar në KQZ, për auditimin financiar të partive politike	KQZ	Korrik 2017		
	2.1 Miratimi i strukturës dhe organikes së KQZ-së	KQZ	Janar 2017		
	2.2 Ngritja e strukturës së specializuar në KQZ	KQZ	Korrik 2017		
3.	Zhvillmi i projektit Twinning, bashkëpunimi me ekspertet e	KQZ	Çdo tremujor, për 36 muaj		

	projektit për të siguruar transparencën e financimit të partive politike dhe bashkëpunimin me palët e interesuara				
	3.1 Forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, për kryerjen e auditimit financiar përmes trajnimeve	KQZ	Korrik 2017		
	3.2 Hartimi i rregullave të brendshme (format raportimi për partitë politike) për rritjen e efikasitetit të transparencës së financimit	KQZ	Mars 2017		
	3.3 Miratimi i Rregullores				
4.	Miratimi i modeleve për raportet financiare të partive politike	KQZ	Mars 2017		
	4.1 Hartimi i modelit të raportimit financiar për fushatën zgjedhore të partive politike duke përfshirë rubrikën e raportimit financiar për kandidatët e partive politike	KQZ	Mars 2017		
	4.2 Miratimi i modelit të raportimit financiar për fushatën zgjedhore të partive politike	KQZ	Mars 2017		
5.	Zhvillmi i modeleve programeve kompjuterike për	KQZ	Prill 2017		

	kontrollin financiar të partive politike				
	5.1 Zhvillimi i modulit për pasqyrimin e raporteve të financave dhe dokumentacionit financiar nga partitë politike	KQZ	Prill 2017		
	5.2 Zhvillimi i modulit për pasqyrimin e raportit të auditimit nga ekspertet kontabël, zhvillimi i modulit për hartimin e raporteve të KQZ-se	KQZ	Prill 2017		
6.	Trajnime për rritjen e kapaciteteve në lidhje me raportimin e financave të partive politike	KQZ	Gusht 2017		
	6.1 Zhvillimi i sesioneve të trajnimit me personat përgjegjës për financat në partitë politike zhvillimi i sesioneve të trajnimit me ekspertet kontabël, për auditimin financiar	KQZ	17 shkurt 2017		
Rekomandim 4: Rritje e mëtejshme e aksesit për prokurorinë dhe policinë në regjistrat kombëtarë publikë elektronikë; zgjerimin e sistemit për menaxhimin e rasteve në prokurori dhe sigurimin e përdorimit të tij në mënyrë efektive					
	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problematika
1.	Implementimi i akseseve në regjistrat elektronikë publikë për luftën kundër krimit të	Policia e Shtetit Drejtoria e TI	24 Prill 2017		

	organizuar dhe krimet financiar të: ZQRPP, DPT, DPD, ALUIZNI, QKB.				
	1.1 Përmirësimi i ndërfaqes midis sistemeve të institucioneve të mësipërme dhe Policisë së Shtetit.	Policia e Shtetit Drejtoria e TI	Qershor 2017		
	1.2 Dhënia e aksesit/pajisja me username për punonjësit e Policisë së Shtetit	Policia e Shtetit Drejtoria e TI	Qershor 2017		
2.	Forcimi i kapaciteteve profesionale në hetimin e trafikimit të lëndëve narkotike nëpërmjet trajnimeve të parashikuara në Planin e Trajnimeve 2017:	Policia e Shtetit	Gusht 2017		
	2.1 Njohuri mbi drogat, llojet dhe zonat kryesore të prodhimit, mënyrat e fshehjes. Rreziqet që hasen gjatë kontrollit të laboratorëve, magazinave dhe ambienteve të tjera. Rrugët kryesore të trafikimit ndërkombëtar. (20 pjesëmarrës)	Policia e Shtetit	02 – 03 Mars 2017		
	2.2 Format dhe metodat speciale	Policia e	03-04 Korrik		

	të hetimit të krimit të organizuar (në fushën e narkotikëve). Operacionet e fshehta policore. Informacioni policor, rekrutimi i informatorëve, menaxhimi dhe roli i informatorëve kundër krimit të organizuar. (20 pjesëmarrës).	Shtetit	2017		
3.	Kryerja e 2 analizave 3 mujore me Prokurorinë e Krimeve të Rënda me qëllim përmirësimin e veprimitarisë hetimore.	Policia e Shtetit / Prokuroria e Krimeve të Rënda	17 prill 2017 17 Korrik 2017		
4.	Rritja e bashkëpunimit me strukturat homologe të vendeve të rajonit si dhe me SELEC dhe EUROPOL, me qëllim shkëmbimin e informacioneve dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta me përdorimin e formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.	Policia e Shtetit	Gusht 2017		
	4.1 Kryerja çdo viti e jo më pak se 30 operacioneve nëpërmjet formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.	Policia e Shtetit	Gusht 2017		

	4.2 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet kontakteve direkte midis strukturave homologe/ takimet operationale të përbashkëta të zhvilluara).	Policia e Shtetit	Gusht 2017		
5.	Rritja me 5% e numrit të referimeve penale për pastrim parash krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.	Policia e Shtetit	Janar-Mars 2017 Prill - Qershor 2017		
6.	Draftimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve mbi marrjen e aksesit në databazat e ZRPP dhe regjistri i prokurimeve publike.	Prokuroria e Përgjithshme ZRPP APP	Korrik 2017		
7.	Implementimi në CAMS i shortit për shpërndarjen e çështjeve në prokurori. Plotësimi dhe vënia në funksion në CAMS i modulit të Prokurorisë së Përgjithshme.	Prokuroria	Korrik 2017		

PRIORITETI 4. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Rekomandimi 1: Të demonstrojë progres të mëtjshëm në ngritjen e një historiku solid (track record) të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare kundër grupeve të krimit të organizuar, duke përfshirë konfiskimin e aseteve kriminale dhe sukses në shkatërrimin e rrjeteve kriminale.

Masa		Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Komente/sugjerime
1.1	Raportimi 6-mujor i statistikave mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin.	MPB/Policia e Shtetit Prokuroria e Përgjithshme Ministria e Drejtësisë	25 korrik 2017		
1.1.1					
1.1.2	Raportimi 6-mujor i statistikave të konsoliduara mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin.				
	Raportimi 6-mujor i track record-it mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin.	MPB/Policia e Shtetit Prokuroria e Përgjithshme Ministria e Drejtësisë	25 korrik 2017		
1.2	Shtirirja e sistemit të Menaxhimit të Çështjes (Një sistem që mundëson dokumentimin e një ngjarjeje kriminale nga njoftimi për ngjarjen deri në dorëzimin e çështjes në Prokurori) në qarqet më të mëdha të vendit	Policia e Shtetit / Drejtoria e IT	Qershor 2017		
1.2.1					

	(Tiranë, Durrës, Elbasan, Lezha, Berat, Vlorë). Trajnimi i 3500 punonjësve të Policisë së Shtetit mbi përdorimin e këtij sistemi.		Qershor 2017		
1.3	Ndërlidhja e 2 sistemeve të Menaxhimit të Çështjeve mes Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme.	Prokuroria e Përgjithshme / Policia e Shtetit	Qershor 2017		
1.4	Miratimi i ndryshimeve në Kodin Penal (KP) dhe Kodin e Procedurës Penale (KPP), në lidhje me Trafikimin e Qenieve Njerëzore (TQN) dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.	Kuvendi	Masa është pjesë e Reformës në Drejtësi		
Rekomandim 2: Të përshtasë (align) ligjet relevante me standartet dhe praktikat më të mira evropiane, në veçanti ligjin anti mafia, kodin e procedurës penale dhe legjislacionin mbi përgjimet dhe mbikëqyrjen, afatet kohore për hetimin dhe pranueshmërinë e provave.					
	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Komente/sugjerime
2.1	Hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i	Kuvendi	Brenda vitit 2017		

	Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.				
2.2	Hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9157, datë 04.12.2003 “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, i ndryshuar”.	Kuvendi	Brenda vitit 2017		
2.3	Hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit”, i ndryshuar.	Kuvendi	Brenda vitit 2017		
<p>Rekomandimi 3: Të decentralizojë forcat e specializuara të policisë, shpërndarjen e burimeve adekuate kundër krimit të organizuar dhe të zbatojë një politikë efektive të burimeve njerëzore duke përfshirë dhe rekrutimin në bazë të meritave, promovimin dhe transferimin brenda policisë dhe prokurorive.</p>					
	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Komente/sugjerime
3.1	Decentralizimi i kryerjes së hetimit të krimit nëpërmjet trajnimit të oficerëve në Drejtoritë Vendore të Policisë, të parashikuara në planin e	Policia e Shtetit			

3.1.1	trajnimeve 2017, me temë:		29-31 Maj 2017		
3.1.2	<p>“Përdorimi i metodave speciale të hetimit të veprave penale të pastrimit të parave bazuar në analizën e informacionit kriminal. Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në hetimin e pastrimit të parave”. (me 20 pjesëmarrës nga strukturat e DVP)</p> <p>“Hetimi i korrupsionit në nivelet e larta të Administratës Publike, korrupsioni në sistemin gjyqësor, korrupsioni në sistemin e tatim-taksave dhe lojërave të fatit, manipulimi i garave sportive, konventa e Këshillit të Evropës”. (me 20 pjesëmarrës nga strukturat e DVP)</p>		22-24 Maj 2017		
3.2	Shpërndarje e burimeve adekuate kundër krimit të organizuar nëpërmjet:	Policia e Shtetit			
3.2.1	Plotësimi të vendeve të lira për gradën “Inspektor”, nga shpërndarja e 288 kursantëve		15 Maj 2017		

3.2.2	<p>që përfundojnë Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegjin e Policisë”.</p> <p>Plotësimi i vendeve të lira në gradën “Nënkomisar”, në strukturat e hetimit të krimit, nga shpërndarja e 124 kursantëve që përfundojnë trajnimin në këtë fushë.</p>		15 Maj 2017		
3.3.1	<p>Zbatimi i një politike efektive të burimeve njerëzore duke përfshirë dhe rekrutimin në bazë të meritave, promovimin dhe transferimin brenda policisë, nëpërmjet:</p>	Policia e Shtetit			
3.3.2	<p>Monitorimit të zbatimit korrekt të ligjit Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të vendimit Nr. 750, datë 16.09.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” dhe të vendimit Nr. 892, datë 21.12.</p>		30 Qershor 2017		
3.3.2	<p>2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”.</p>		30 Qershor 2017		

<p>3.3.3</p>	<p>Kryerjes së procedurës së planifikimit për hapjen e konkurrimit për gradën “Komisar”, “K/komisar” dhe “Drejtues”.</p> <p>Transferimet e punonjësve të policisë, të bëhen sipas: vendimit Nr. 750, datë 16.09.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” dhe vendimit Nr. 892, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”. Për rastet kur punonjësi i policisë transferohet, të përputhet grada e tij me funksionin organik, ku ai do të caktohet.</p>		<p>Qershor 2017 dhe në vazhdim</p>		
<p>Rekomandimi 4: Rritje e mëtejshme e aksesit për prokurorinë dhe policinë në regjistrat kombëtarë publikë elektronikë; zgjerimin e sistemit për menaxhimin e rasteve në prokurori dhe sigurimin e përdorimit të tij në mënyrë efikase. Të vejë në përdorim më të lartë investimet financiare</p>					

dhe inteligjente mbi pastrimin e parave dhe trafikimin e drogës duke rritur konfiskimin e aseteve.

Masa		Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Komente/sugjerime
4.1	Zbatimi i marrëveshjeve për aksesimin në regjistrat elektronikë publikë për luftën kundër krimit të organizuar dhe krimit financiar të: ZQRPP, DPT, DPD, ALUIZNI, QKB	Policia e Shtetit Drejtoria e IT	Qershor 2017		
4.1.1	Përmirësimi i ndërfaqes midis sistemeve të institucioneve të mësipërme dhe Policisë së Shtetit.		Qershor 2017		
4.1.2	Dhënia e aksesit/pajisja me username për punonjësit e Policisë së Shtetit.		Qershor 2017		
4.2	Forcimi i kapaciteteve profesionale në hetimin e trafikimit të lëndëve narkotike nëpërmjet trajnimeve të	Policia e Shtetit	Gusht 2017		

<p>4.2.1</p> <p>4.2.2</p>	<p>parashikuara në Planin e Trajnimeve 2017:</p> <p>-Njohuri mbi drogat, llojet dhe zonat kryesore të prodhimit, mënyrat e fshehjes. Rreziqet që hasen gjatë kontrollit të laboratorëve, magazinave dhe ambienteve të tjera. Rrugët kryesore të trafikimit ndërkombëtar. (20 pjesëmarrës)</p> <p>-Format dhe metodat speciale të hetimit të krimit të organizuar (në fushën e narkotikëve). Operacionet e fshehta policore. Informacioni policor, rekrutimi i informatorëve, menaxhimi dhe roli i informatorëve kundër krimit të organizuar. (20 pjesëmarrës).</p>		<p>02 – 03 Mars 2017</p> <p>03-04 Korrik 2017</p>		
<p>4.3</p>	<p>Kryerja e 2 analizave 3 mujore me Prokurorinë e Krimeve të Rënda me qëllim përmirësimin e veprimtarisë hetimore.</p>	<p>Policia e Shtetit / Prokuroria e Krimeve të Rënda</p>	<p>17 prill 2017 17 Korrik 2017</p>		

4.4	Rritja e bashkëpunimit me strukturat homologe të vendeve të rajonit si dhe me SELEC dhe EUROPOL, me qëllim shkëmbimin e informacioneve dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta me përdorimin e formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.	Policia e Shtetit	Gusht 2017		
4.4.1	Kryerja çdo viti e jo më pak se 30 operacioneve nëpërmjet formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.				
4.4.2	Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet kontakteve direkte midis strukturave homologe/				

	takimet operationale të përbashkëta të zhvilluara).				
4.5	Rritja me 5% e numrit të referimeve penale për pastrim parash krahasuar me të njëjtën periudhe të një viti më parë.	Policia e Shtetit	Janar-Mars 2017 Prill - Qershor 2017		
4.6	Draftimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve mbi marrjen e aksesit në databazat e ZRPP dhe regjistri i prokurimeve publike.	Prokuroria e Përgjithshme ZRPP APP	Korrik 2017		
4.7	Implementimi në CAMS i shortit për shpërndarjen e çështjeve në prokurori. Plotësimi dhe vënia në funksion në CAMS i modulit	Prokuroria	Korrik 2017		

të Prokurorisë së Përgjithshme.

PRIORITETI 5 - TË DREJTAT E NJERIUT

Rekomandim 1: Të sigurohet zbatimi i të drejtave të pronës dhe proceset e regjistrimit të pronës, si dhe të kompletohet kthimi dhe kompensimi

	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problemtika
1.	Përfundimi i Regjistrimit fillestar në 3 ZK me rreth 15,000 pasuri të paluajtshme ku ka përfunduar afishimi publik.	ZRPP	Mars.2017		
	1.1 Kontrolli teknik dhe ligjor i produktit të Fazës II të regjistrimit fillestar.	ZRPP	Shkurt 2017		
	1.2 Shtyrja e kontratës së regjistrimit fillestar për të bërë të mundur përfundimin e procesit.	ZRPP	Shkurt 2017		
	1.3 Dorëzimi i produkteve të finalizuara të Fazes II.	ZRPP, Kontraktori	Shkurt 2017		

		për regjistrimin fillestar			
	1.4 Ligjërimi i regjistrimit fillestar dhe ngarkimi në sistem i të dhënave të pasurive të paluajtshme.	ZRPP	Mars 2017		
2.	Afishimi Publik i regjistrimit fillestar për 343,000 ha pyje dhe kullota që transferohen në pronësi të Bashkive.	ZRPP	Shtator 2017		
	2.1 Administrimi i informacionit teniko-ligjor për ZK ku do të shtrihet ky proces i regjistrimit fillestar.	ZRPP, Kontraktori për regjistrimin fillestar	Prill 2017		
	2.2 Krijimi i Hartës Kadastrale.	Kontraktori për regjistrimin fillestar	Maj 2017		
	2.3 Plotësimi i Kartelave të Pasurive të Paluajtshme.	Kontraktori për regjistrimin fillestar	Qershor 2017		
	2.4 Dorëzimi i Produktit të Fazës I të regjistrimit	Kontraktori për	Korrik 2017		

	filleshtar.	regjistrimin filleshtar			
	2.5 Kontrolli i Cilësisë së Produktit të Fazës I.	ZRPP, Supervizori	Gusht 2017		
	2.6 Afishimi Publik.	Bashkitë përfituese, Kontraktori për regjistrimin filleshtar	Shtator 2017		
3.	Përfundimi i Regjistrimi Filleshtar në ZK 8220 Tiranë me rreth 11,000 pasuri të paluajtshme	ZRPP	Shtator 2017		
	3.1 Krijimi i Hartës Kadastrale.	ZRPP	Prill 2017		
	3.2 Plotësimi i Kartelave të Pasurive të Paluajtshme.	ZRPP	Maj 2017		
	3.3 Skanimi i dokumentacionit	ZRPP	Maj 2017		
	3.4 Afishimi Publik.	ZRPP	Korrik 2017		
	3.5 Ligjërimi i regjistrimit filleshtar dhe ngarkimi në sistem i të dhënave të pasurive të paluajtshme.	ZRPP	Shtator 2017		

4.	Afishimi Publik për 30,000 pasuri të paluajtshme	ZRPP	Shtator 2017		
	4.1 Krijimi i Hartës Kadastrale.	ZRPP	Korrik 2017		
	4.2 Plotësimi i Kartelave te Pasurive te Paluajtshme.	ZRPP	Gusht 2017		
	4.3 Skanimi i dokumentacionit.	ZRPP	Gusht 2017		
	4.4 Afishimi Publik.	ZRPP	Shtator 2017		
5.	Plani i veprimit për zbatimin e ligjit nr.133/2015 (Raportime mujore)	ATP	Janar – Korrik 2017		
	5.1 Produkti 1. Vlerësimi financiar për vendimet (1995 – XX) përfundimtare për kompensim që kanë njohur këtë të drejtë, të vlerësuara sipas metodologjisë së miratuar në ligj.	ATP	Janar – Korrik 2017		

	<p>5.2 Shpërndarja e fondit për kompensim financiar nga buxheti i shtetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aplikimet për kompensim financiar - Shqyrtimi i dosjeve - Shpërndarja e fondit 	ATP	Janar – Korrik 2017		
	<p>5.3 Shpërndarja e fondit financiar për kompensim për kërkesa të veçanta (kompensim progresiv = 1/3 nga buxheti i shtetit):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aplikimet për kompensim progresiv - Shqyrtimi i kërkesave - Shpërndarja e fondit 	ATP	Janar – Korrik 2017		
	<p>5.4 Shpërndarja e fondit fizik</p> <p>Shpërndarja e fondit fizik nga Fondi i Tokës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aplikimet për kompensim fizik - Shqyrtimi i kërkesave - Shpërndarja e fondit për kompensim fizik 	ATP	Janar – Korrik 2017		

	<p>5.5 Trajtimi me vendim të kërkesave të subjekteve që kanë aplikuar për njohjen e pronës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të kryhet procesi i njoftimeve dhe konfirmimeve për dosjet në shqyrtim - Dalja me vendime 	<p>ATP</p>	<p>Janar – Korrik 2017</p>		
<p>Rekomandim 2: Përjashtimi social dhe diskriminimi duhet të luftohet nëpërmjet një zbatimi më të mirë të politikave dhe bashkëpunimit më të mirë institucional. Duhet më shumë përpjekje për të zhvilluar një historik të rasteve antidiskriminim</p>					
	<p>Masa</p>	<p>Institucioni përgjegjës</p>	<p>Afati</p>	<p>Realizimi</p>	<p>Problematika</p>
	<p>1. Përfshirja e punëkërkesve të papunë nga komuniteti Rom dhe Egjiptianë në programet e punësimit dhe ato të formimit profesional</p>	<p>MMSR</p>	<p>Janar-Korrik 2017</p>		
	<p>1.1 Rritja me 10% e numrit të romëve dhe egjiptianeve pjesëmarrës në programet e punësimit :</p> <ul style="list-style-type: none"> 1. Punësimi për grupet e veçanta 2. Trajnimin nëpërmjet punës 	<p>MMSR/SHK P</p>	<p>Mars-Korrik 2017</p>		

	3. Punësimi i grave kryefamiljare me fëmijë në ngarkim dhe nënat e reja, sipas VKM-ve përkatëse.				
2.	Trajnimi i 16 nëpunësve gjinorë të ministrive për mosdiskriminimin e personave LGBTI	MMSR, Ministrinë e linjës	Shkurt 2017		
3.	Zhvillimi i një trajnimi të 14 koordinatorëve për çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel qendror dhe 61 pika fokale në nivel vendor për aspekte të ndryshme të aksesueshmërisë.	MMSR, Ministrinë e linjës Bashkitë	Maj - Qershor 2017		
4.	Zhvillimi i një cikli trajnimi me qëllim ngritjen e kapaciteteve të Inspektoriatit Shtetëror të Punës të cilët gjatë inspektimeve të tyre do të kontrollojnë edhe nivelin e aksesueshmërisë.	MMSR Inspektorati Shtetëror i Punës	Qershor - Korrik 2017		
5	Përmirësimi i bazës së të dhënave për menaxhimin e rasteve të diskriminimit.	KMD	Dhjetor 2017 (raportim mujor)		

Rekomandim 3: Legjislacioni mbi drejtësinë për minorenët duhet përshtatur me standardet ndërkombëtare. Shërbimet për viktimat e dhunës në familje duhet përmirësuar në kualitet, masë, mundësi aksesit dhe mbulim gjeografik

	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problematika
1.	Zhvillimi i Fushatës së Komunikimit kundër dhunës në familje “Unë zgjedh të jetoj pa dhunë”	MMSR	Janar – Mars 2017		
2.	Tryeza konsultative për Amendime në “ Ligjin për Masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” 2.1 Tryezë me Aleancën e Grave Deputete, të Komisioneve të tjera Parlamentare dhe aktorë të fushës. 2.2 Tryezë konsultative me institucionet përgjegjëse për ndryshimet në LDHF	MMSR Ministritë e linjës	Shkurt 2017 Maj 2017		
3	Trajnimi i 30 koordinatorëve vendorë në njësitë e reja territoriale për përdorimin e sistemit REVALB nëpërmjet 2 cikle trajnimesh	MMSR Bashkite	Shkurt 2017		

	3.1 Cikli i parë i trajnimimit të koordinatorëve vendorë të dhunës në familje 3.2 Cikli i dytë i trajnimimit të koordinatorëve vendorë të dhunës në familje		Mars 2017		
4	Monitorimi i vazhdueshëm, çdo 6 muaj, i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Qendra Kombëtare e Viktimave të dhunës në famije	MMSR	Gusht 2017		
5	Ngritja e Qendrave për viktimat e dhunës në familje në kuadrin e reformës së shërbimeve shoqërore. Në kuadër të Fushatës së Mirëqenies Sociale do të firmosen Pakte Sociale me 61 Bashki	MMSR - Bashkitë	Janar-Mars 2017		
6	Hartimi dhe miratimi i “Strategjisë së Drejtësisë për të miturit”	MD	Shtator 2017		
	6.1 Hartimi i draftit fillestar	MD	Mars 2017		
	6.2 Buxhetimi i Projekt strategjisë	MD	Prill 2017		
	6.3 Konsultimi i Projekt strategjisë	MD	Qershor 2017		

	6.4 Reflektimi sugjerimeve	MD	Korrik 2017		
	6.5 Përgatitja e draftit final	MD	Gusht 2017		
	6.6 Dërgimi i draftit në Këshillin e Ministrave për miratim	MD	Shtator 2017		

Rekomandim 4: Të paraqitet legjislacioni në linjë me praktikat me të mira ndërkombëtare mbi reklamimin shtetëror për të rritur transparencën

	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problematika
1.	Diskutimi dhe Konsultimi për kuadrin ligjor ekzistues për reklamën shtetërore , problematika e deritanishme dhe hapat e mundshëm për t’u ndërmarrë	AMA, MIAP, KM (APP) Kuvendi	2017		

Rekomandim 5: Të paraqiten kufizime pronësie për operatorët kombëtare në linjë me standardet ndërkombëtare relevante

	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problematika
1.	Hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, i		2017 dhe në vijim		

	cili parashikon kufizime të pronësisë për operatorët kombëtare në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare				
Rekomandim 6: Të forcohet më tej pavarësia e autoritetit rregullues dhe transmetuesit publik					
	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problematika
1.	Garantimi i zbatimit të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, për sigurimin e pavarësisë së Autoritetit rregullator AMA dhe RTSH	Kuvendi, AMA, RTSH , organet e tjera ligjzbatuese	2017 e në vijim		
2.	Garantimi i pavarësisë institucionale në zbatim të detyrimeve ligjore gjatë procesit zgjedhës, në nevojat buxhetore dhe strukturore për sa parashikon si dhe në kordinimin e rolit mbikqyres dhe bashkeveprues të Kuvendit me AMAn , RTSH dhe institucione të tjera për	Kuvendi , Qeveria			

	ndjekjen e zbatimit efikas te rekomandimeve per këto institucione me qellim eficencen dhe pergjegjshmerine e tyre				
Rekomandim 7: Plotësimi dhe Finalizimi i procesit të përgatitjes se Ligjit që do të siguroje të drejta të barabarta për anëtarët e të gjitha minoriteteve.					
	Masa	Institucioni përgjegjës	Afati	Realizimi	Problematika
1	Përfundimi i procesit te konsultimit të projektligjit	MPJ, institucionet pjesëmarrëse të Grupit të Punës, OSHC	Mars 2017		
2	Përfundimi i hartimit të ligjit	MPJ	Prill 2017		
3	Miratimi i ligjit në Këshillin e Ministrave	MPJ	Maj 2017		